



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Seanca nr.2003/01
Prishtinë,më 9 janar 2003,ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi z.Nexhat Daci,kryetar i Kuvendit të Kosovës,kurse bashkëkryesues ishte z.Bajram Kosumi.

Kryesusi pasi konstatoi numrin e deputetëve të pranishëm në seancë,gjithsej 82 shpalli të hapur punën e saj.

Për këtë seancë ishte paraparë ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Procesverbali nga seanca e kaluar;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit "Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë"
4. Shqyrtimi i Rregullorës së Punës të Kuvendit të Kosovës;
- 5 Shyrtimi i kërkesës së "Komiteteve tjera" për emrimin e një anëtari të Kryesisë nga radha e tyre;
6. Parashtrimi i pyetjeve-përgjigjet e ministrave.

Kryesusi i informoi deputetët për takimin që kishte pasur me kryetarët e grupeve parlamentare dhe vendimin që kishin miratuar, që në seancën e ardhshme plenare të shqyrtohet gjendja e sigurisë në Kosovë

1. **Miratimi i rendit të ditës.**

Kryesusi kërkoi nga deputetët miratimin e rendit të ditës.

Besa Gaxheri tha se në vazhden e vrasjeve dhe krimeve që po bëhen në Kosovë, Kuvendi duhet të mbajë një minutë heshtje për të rënë në Pejë.

Kryesusi tha se i përkrah shqetësimet e znj. Gaxheri, por kërkoi nga deputetët që Kuvendi t'i kryejë obligimet dhe kompetencat e tij sipas Korinizës Kushtetuese dhe të procedohet me propozimin e rendit të ditës.

Kryesusi konstatoi miratimin e rendit të ditës.

2. Procesverbali nga seanca e kaluar.

Nuk pati vërejtje lidhur me procesverbalin nga seanca e kaluar dhe ai u miratua.

3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”.

Kryesoi e ftoi ministrin e Ekonomisë dhe Financave z. Ali Sadriu që ta arsyetojë P/ligjin para deputetëve.

Ministri Ali Sadriu tha se ky P/ligj shërben si gurthemel i sistemit që të sigurojë përdorimin racional, efikas dhe transparent të parave publike. Paratë publike nuk do të përdoren në mënyrë kundërligjore për të shtuar pasurinë e ndonjë individi apo grupacioni të caktuar. Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë rolin qendror në përcaktimin dhe zbatimin e buxhetit publik, theksoi z. Sadriu.

P/ligji jep udhëzimet e Kuvendit për Qeverinë se si dhe kur duhet të përgatisë Qeveria Projektbuxhetin vjetor dhe P/ligjin për ndarjet buxhetore.

Qeveria ka punuar në hartimin e këtij P/ligji më se shtatë muaj, vazhdoi z. Sadriu ku kanë qenë të angazhuar ekspertë vendor, dhe ekspertët ndërkombëtarë, për cka i falenderoi ai. Qeveria gjatë hartimit të P/ligjit, theksoi z. Sadriu i ka harmonizuar qëndrimet e veta me Zyrën e këshilltarit juridik të PSSP-së.

P/ligji siguron përgjegjësitë e autoriteteve dhe organizatave që pranojnë para publike, të pjesa e 10 e tij, parashikon kërkesën për mbajtjen e llogarisë dhe për raportim të ndërmarrjeve dhe kompanive kryesore publike, sic janë: KEK-u, PTK-ja, Aeroporti etj.

Kryesusi hapi debatin për shqyrtimin e P/ligjit në parim.

Fatmir Rexhepi tha se ky P/ligj është dashur të shqyrtohet në shtator të vitit të kaluar dhe s' di pse ai është vonuar? P/ligji në fjalë, vazhdoi z. Rexhepi brenda 13 pjesëve, mbulon mirë fushën për buxhetin, rregullon dhe përcakton autoritetin e institucioneve qendrore dhe komunale.

Vërejtjet e tij në parim z. Rexhepi tha se kanë të bëjnë me njësit brenda Ligjit, në pjesët 2, 3, 4, 9, 11 dhe 12 të cilat, sipas tij kanë fuqi të mëdha delegeuse të vendimë marrjes nga një autoritet i caktuar brenda tij. Kjo, sidomos është e theksuar, vazhdoi z. Rexhepi me kompetencat për emrimin e drejtorit të thesarit, revizorit,

Shërbimit doganorë, është dashur ta ketë Kuvendi i Kosovës. Z.Rexhepi pati vërejtje edhe në kompetencat e PSSP-së që kanë të bëjnë me investimet e parave publike. Në parim, ai tha se e përkrah këtë P/ligj.

Haki Shatri tha se e përkrah fjalën e hapjes të ministrit Sadriu, por pati disa vërejtje në këtë P/ligj. Ai nuk rregullon në mënyrë të mjaftueshme shkrijën e AQF-së në Ministrinë e ekonomisë dhe Financave. Gjithashtu nuk i është kushtuar rol të mjaftueshëm Kuvendit dhe Qeverisë gjatë procedurës së miratimit dhe zbatimit të raportimit. Në parim, theksoi z. Shatri e përkrah këtë P/ligj, të cilin gjatë shqyrtimit nëpër komisionet e Kuvendit duhet të plotësohet.

Ramadan Kelmendi tha se e përkrah fjalën e hapjes të ministrit Sadriu, por pati edhe disa vërejtje në P/ligj. Nuk janë përcaktuar kompetencat dhe lidhjet hierarkike në mes departamentit komunal të politikave të buxhetit dhe Ministrisë për ekonomi dhe financa. Përveç njësive të revizionit të brendshëm financiar duhen të përcaktohen edhe njësitë qendrore të revizionit financiar të cilat duhet të kenë autoritetin mbi revizionin financiar të brendshëm të të dy niveleve. Duhet krijuar instrumente adekuate juridike për kontrollin e buxhetit tek të gjitha subjektet shfytëzuese të buxhetit të Kosovës. Në parim, theksoi z. Kelmendi e përkrah këtë P/ligj.

Pas këtyre diskutimeve, kryesusi e hodhi në votim P/ligjin në fjalë.

Për -----82;

Kundër-----00;

Abstenime---00.

Kryesusi kontatoi se Kuvendi i Kosovës miratoi në parim P/ligjin “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-2002/11”.

4. Shqyrtimi i Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës.

Kryesusi i informoi deputetët me punën e Komisionit të përkohshëm për hartimin e Rregullorës së punës të Kuvendit të Kosovës. Ai falenderoi anëtarët e Komisionit dhe të gjithë ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë kontribuar në hartimin e saj dhe ftoi kryetarin e Komisionit që ta arsyetojë atë para deputetëve.

Arsim Bajrami tha se P/Rregullorja në fjalë ka tri qëllime kryesore: a) Që të shtojë efikasitetin e Kuvendit dhe të procedurave ligjvënëse në të; b) të vendosë një rend në Kuvend, duke përcaktuar rregullat e debatit parlamentar; dhe c) të krijojë një bazë juridike për punën e Komisioneve të Kuvendit. Gjatë hartimit të P/Rregullorës, vazhdoi z. Bajrami Komisioni ka pasur parasysh modelet e parlamenteve: të Kongresit Kanadez, Parlamentit të Irlandës, Kroacisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë.

Rregullorja ka gjithsej 50 Rregulla dhe tri anekse (shtesa), të cilat janë pjesë përbërse e saj. Shtesa e parë i referohet të drejtave dhe detyrimeve të deputetëve; e dyta i referohet punës së Komisioneve të Kuvendit; dhe e treta është Kodi i sjelljes së deputetëve.

Z. Bajrami elaboroi çështjet që janë normuar në këtë P/rregullore e që ndryshojnë nga ajo e mëparshmeja, e këto janë: procedurën e seancës inaguruese; teksti i betimit të deputetëve; imuniteti i deputetëve; procedurat e parashtrimit të mocioneve të përgjegjësive së ekzekutivit dhe përgjegjësit e kryetarit të Kosovës; çështja e emrimit të gjyqetarëve dhe prokurorëve; renditja e folësve në Kuvend; limitimi i kohës në 5 përkatësisht në 10 minuta (për shefat e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve); racionalizimi i procedurës ligjvënëse dhe mënyra e shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve; raportet e Kuvendit me PSSP-në. Diskutimi i plotë i z. Bajrami i është bashkangjitur transkriptit.

Sabri Hamiti tha se e përkrah diskutimin e z. Bajrami. Ai propozoi edhe ndryshime të cilat duhet të inkorporohen në tekstin e P/Rregullorës. Në Rregullën e 19-të duhet të shtohet si pikë e vecantë 19.3 dhe të thuhet: "Kryesia do të konsultohet me kryetarët e grupeve parlamentare për caktimin e rendit të ditës të seancave plenare të Kuvendit", dhe në Rregullën 3, duhet të shtohet 3.8 e të thuhet: "ku do të do të trajtohen kryetarët e grupeve parlamentare njësoj sikur kryetarët e komisioneve".

Fatmir Limaj në emër të grupit parlamentar të PDK-së tha se e përkrah Rregullorën e hartuar nga Komisioni dhe Kryesia e Kuvendit dhe falenderon gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e saj. Z. Limaj tha se i përkrah propozimet e parafolsit të tij. Në Rregullore duhet të parshihet edhe iniciativa e lirë e qytetarëve, në trajtimin e problemve që janë shqetësim i qytetarëve, të cilat Kryesia e Kuvendit në procedurë të paraparë duhet t'i radhisë për shqyrtim në seanca plenare. Z. Limaj ngriti edhe çështjen e rregullimit të imunitetit të deputetëve të cilën duhet zgjidhur.

Bujar Dugolli tha se e përkrah P/Rregullorën e propozuar. Ai pati edhe disa propozime. Në dispozitat themelore të saj, thuhet, përveç organizimit dhe funksionimit të Kuvendit, Kryesisë së tij, Komisioneve parlamentare, duhet t'i shtohet edhe "të grupeve parlamentare". Në Rregullën e 19-të ku flitet për rendin e ditës, përveç anëtarëve të Kryesisë duhet të propozojnë edhe shefat e grupeve parlamentare. Në Rregullën e 25, ku flitet për çështje të ngutshme, nuk duhet të jetë se "mund të kërkoj secili deputet", por "grupet parlamentare mund të shtrojnë çështje të ngutshme në konsultim me kryetarin e Kuvendit".

Xhezair Murati tha se në emër të grupit që ai përfaqëson, falenderon punën e atyre që kanë hartuar këtë Rregullore. Ai pati edhe sygjerime përsa i përket "interesave të komuniteteve të vogla" dhe propozoi që në Rregullën e 36-të ku parashihet minimumi 5 të jetë 3 deputetë. Ai këtë e arsyei duke pasur numrin e vogël të deputetëve "te komunitetve të vogla" e që shpeshherë, sipas tij mund të kenë interese të ndryshme.

Në këtë P/Regullore vërejtjet, sygjerimet dhe propozimet e tyre i dhanë edhe deputetët: Fatmir Sejdiu, Sabile Basha, Exhlale Salihu, Berat Luzha, Sabit Rustemi, Ismajl Kurteshi, Fatmir Rexhepi, Flora Brovina, Hydajet Hyseni, Ramadan Kelmendi, Hatixhe Hoxha, Fadil Kryeziu, Sanije Alaj, Agim Krasniqi dhe Hilmo Kandiç, diskutimet e të cilëve i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesusi dha një orë pauzë,gjatë së cilës Komisioni për hartimin e Rregullorës dhe kryetarët e grupeve parlamentare, duhet t'i inkorporojnë në tekstin final të Rregullorës vërejtjet dhe propozimet e delegatëve dhe pastaj ajo të miratohet.

Kryesusi e ftoi kryetarin e Komisionit për hartimin e Rregullorës së Kuvendit që të paraqes tekstin përfundimtar të saj para deputetëve.

Arsim Bajrami tha se Komisioni i Kuvendit të Kosovës për hartimin e Rregullorës së përkohshme të Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare,gjatë pauzës së seancës plenare me koncensus,morën këto

REKOMANDIME

1. Komisioni i miratoi të gjitha vërejtjet gjuhësore dhe teknike në tekstin e Rregullorës të cilat i propozuan deputetët;
2. Komisioni i miratoi të gjitha vërejtjet e deputetëve lidhur me zgjerimin e fushëveprimit të komisioneve parlamentare që janë në pajtim me Rregullorën;dhe
- 3.Komisioni autorizoi Kryesinë e Kuvendit që të bëjë finalizimin gjuhësor dhe redaktorial të Rregullorës dhe të njejtën ta botojë sa më shpejtë.

Z.Bajrami i lexoi amendamentet që i ka përgatitur Komisioni dhe kryetarët e grupeve parlamentare gjatë pauzës(12 amendamente),të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesusi e hodhi në votim Rregullorën e përkohshme të punës së Kuvendit të Kosovës,në të cilën duhet të inkorporohen edhe amendamentet e miratuara të Komisionit gjatë pauzës,dhe rezultati i votimit ishte:

Për -----74;
Kundër— 00;
Abstenime—2.

Kryesusi konstatoi:Kuvendi i Kosovës miratoi Rregullorën e përkohshme të punës së tij.

5.Shqyrtimi i kërkesës së “Komuniteteve tjera” për emrimin e një anëtari të Kryesisë së Kuvendit nga radhët e tyre,sipas marrëveshje.

Kryesusi i informoi deputetët me kërkesën e “Komuniteteve tjera”(jo shqiptare dhe jo serbe),të cilën e ka shqyrtuar Kryesia e Kuvendit dhe i ka propozuar seancës plenare këtë

KONKLUZION

Përkrahet kërkesa e “Komuniteteve tjera”(jo shqiptare dhe jo serbe) për ndërrimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nga radhët e tyre,të z.Haxhi Zylfi Merxha dhe në vend të tij emrohet znj.Nafije Gash,nga Partia Demokratike Turke.

Kryesusi e falenderoi z.Merxha për kontributin e dhënë në punën e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe i dëshiroi punë të mbarë në Kuvendi.

Kryesusi e paraqiti në votim kërkesën e “Komuniteteve tjera” dhe rezultati ishte:

Për -----shumica;
Kundër ----- 03;dhe
Abstenime-----01.

Kryesusi konstatoi se znj.Nafije Gash u emrua anëtare e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Hajredin Kuqi tha se në marrëveshjen e “Komuniteteve tjera” thuhet se duhet të bëhet ndërrimi i anëtarit të Kryesisë nga radhët e tyre në cdo vit,por kjo vlen edhe për ndërrimin e anëtarit të tyre në Qeverinë e Kosovës.

Haxhi Zylfi Merxha tha se është e vërtetë që ka qenë marrëveshja e “Komuniteteve tjera”që anëtari i Kryesisë të ndrrohet për cdo vit nga radhët e tyre,por ajo ka qenë marrëveshje gojore,jo me shkrim dhe ajo cka është gojore nuk është e vlefshme.Por,pasi që Kuvendi vendosi kështu,theksoi z.Merxha sipas kërkesës së “Komuniteteve tjera”,e njejta gjë duhet të vlejë edhe për ministrin në Qeverinë e Kosovës nga radhët e “Komuniteteve tjera”.

Bujar Dugolli e falenderoi z.Zylfi Merxha për kontributin e dhënë në punën e Kryesisë dhe përgëzoi znj.Nafije Gash në detyrën e re dhe kërkoi që i njejti ndërrim të bëhet edhe në Qeverinë e Kosovës.

Xhezait Murati sqaroi marrëveshjen e “Komuniteteve tjera” (Komunitetet e Romëve-Ashkalive,Turqëve dhe Boshnjakëve) në të cilën parashihet ndërrimi i anëtarit të Kryesisë për cdo vit nga radhët e tyre.Në atë marrëveshje,theksoi z.Murati nuk është bërë fjalë për ndërrimin e anëtarit të Qeverisë nga këto komunitete.

Xhevdet Neziraj përkrahu parafolsit e tij që të bëhet ndërrimi edhe në Qeverinë e Kosovës nga radhët e ‘Komunitetve tjera’,sikur në Kryesinë e Kuvendit.

Hilmo Kandiq tha se i përkrahë qëndrimet e z.Kuqi dhe Neziraj për ndërrimin e anëtarit të Qeverisë,konform me atë që u vepruar në Kryesinë e Kuvendit.

Sadik Idrizi tha se prej fillimit të konstituimit të organeve vetëqeverisëse të përkohshme të Kosovës ka qenë i pranishëm dhe në asnjë marrëveshje nuk qëndron që të ndërrohet edhe ministri nga radha e këtyrë komuniteteve në Qeverinë e Kosovës.Ai propozoi që të shiqohen procesverbalet dhe stenogramet e atyre mbledhjeve dhe konform tyre të veprohet.

6.Parashtrimi i pyetjeve-përgjigjet e ministrave.

6.1 Deputetja Flora Brovina i kishte parashtruar pyetje Qeverisë së Kosovës se cka ka bërë ajo lidhur me gjetjen e personave rrëmbyer,të zhdukur e të vrarë dhe kufomatë e zvarrosura e të zhdukura?

Kryeministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së znj.Brovina.Ai tha se çështja të cilën e shtron znj.Brovina është një problem madhor si për Kuvendin,Qeverinë,partitë politike dhe gjithë qytetarët e Kosovës.

Angazhimet e Qeverisë së Kosovës,vazhdoi z.Rexhepi kanë qenë të përqëndruara në kontaktet me faktorët ndërkombëtar dhe ngritjen e çështjes së personave që s'janë gjetur.Kërkesa në vecanti i është drejtuar përfaqësuesve të Këshillit të Evropës,që të mos bëjnë pranimin e RFJ-së pa dhënë informata për personat që ende s'janë gjetur.Në kontaktet që kemi pasur me z.Steiner dhe Zyrën e UNMIK-ut për personat ende s'janë gjetur, kemi kërkuar që të ushtrojnë presion mbi Beogradin që të zgjidh këtë çështje.Kemi pasur kontakte,theksoi z.Rexhepi me familjarët e personave të tillë dhe me asocionet e tyre.Qeveria në tri mbledhje e ka diskutuar këtë çështje dhe ka vendosë që ta themelojë një komision i cili do të merret me këtë çështje dhe do t'i bashkërendis veprimet me Komisionin përkatës të Kuvendit dhe Zyrën e UNMIK-ut,asociacionin e famijleve të personave të tillë dhe KMDLNJ-në.Përgjigjja e plotë e kryeministrit i është bashkangjitur transkriptit.

6.2 Deputeti Alush Gashi i kishte parshtruar pyetje Ministrin të Shëndetësisë për gjendjen në shëndetësi dhe rekomandimet e saj.

Ministri Numan Baliq tha se pyetja e z.Gashi është mjaftë e gjërë dhe kërkon debat të vecantë.Gjendja në shëndetësinë e Kosovës,theksoi z.Baliq është e njejtë me gjendjen e përgjithshme në shoqërinë kosovare,me të cilën nuk është edhe ai i kënaqur.Ministria e Shëndetësisë ka bërë mjaftë për përmirësimin e çështjes së shëndetësisë:Është organizuar Ministria e Shëndetësisë;Janë bërë investime të mëdha në projektë të ndryshme të shëndetësisë në lëmin e mjekësisë familjare,mjekësisë sekundare dhe terciare;Është punuar në furnizimin,deponimin,distribuimin dhe disperzimin e barnave;Është punuar në përgatitjen e Ligjit për shëndetësi,me të cilin do të rregullohet çështja e praktikës private;Janë renovuar disa spitale regjionale dhe janë bërë shumë punë me të cilat janë përmirësuar disa padrejtësi lidhur me mjekimin e pacientëve dhe korupcionin.Aktiviteti i Ministrisë së Shëndetësisë,theksoi z.Baliq gjatë vitit 2002 ka krijuar parakushte për marrjen e masave efikase në vitin 2003.

Alush Gashi tha se ka kërkuar nga Ministri i Shëndetësisë një analizë për gjendjen në shëndetësi me rekomandimet e Ministrisë lidhur me këtë.

6.3 Deputeti Blerim Baruti i kishte parashtruar pyetje ministrit të Transportit dhe telekomunikacionit,se cka ka bërë ajo Ministri për t'i përfshirë qytetarët e pjesëve të lagjeve të Mitrovicës Veriore në rrjetin legal të telefonisë së Kosovës?

Ministri Zef Morina i është përgjigjur me shkrim kësaj pyetje,e cila i është shpërndarë deputetëve.

6.4. Deputeti Alush Gashi i kishte parashtruar pyetje ministrin të Transportit dhe Telekomunikacionit se cka ka bërë ajo Ministri lidhur me standardizimin e rrethojave rrugore për parandalim të automjeteve që mos t'i rrezikojnë udhëtarët në trotuare dhe cilat janë veprimet e Ministrisë për sigurimin e sinjalizimeve në vendkalimet afër shkollave në pjesët rurale?

Ministri Zef Morina kësaj pyetje i është përgjigjur me shkrim,dhe ajo i është shpërndarë deputëtëve.

Seanca plenare përfundoi në orën 14:20 minuta

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
akademik Nexhat Daci